

Më dhuro një tregim



Family Literacy

Një projekt për nxitjen e leximit
për familjet me prejardhje emigruese



Ju si prindër jeni ekspert për zhvillimin gjuhësor dhe për mbështetjen gjuhësore të fëmijëve tuaj. Këtu ju mund të gjeni sugjerime, se si ju mund ta zgjoni tek fëmija juaj dëshirën për gjuhën dhe leximin.



Te folurit në gjuhën amtare

Nëse ju flisni me fëmijën tuaj në atë gjuhë që ju e përvetësoni më mirë, i jepni kështu atij një bazë të sigurtë për mësimin e gjuhëve të tjera.



Nxitja për lexim: familja luan një rol vendimtar

Një gjuhë amtare e përvetësuar si duhet dhe përvojat e shumëllojshme në të shkruar janë baza më e mirë për të mësuarit e gjuhës gjermane dhe mësimin e leximit në shkollë.

Projekti *Më dhuro një tregim - Family Literacy* i Institutit Zviceran për Mediat Fëmimore dhe Rinore SIKJM mbështet prindërit me prejardhje emigruese me përkrahjen e fëmijëve të tyre në gjuhë dhe lexim dhe inkurajon ata, të përkushtojnë kujdes gjuhës së tyre amtare.

Dëgjoni dhe jepni përgjigje

Fëmija juaj e zhvillon gjuhën e tij në bisedë me ju.

Nëse ju flisni me të për vëzhgimet e tij, ai e zhvillon kështu leksikun dhe krijon dëshirë për zbulimin e gjërave të reja.



Animime (aktivitete gjallëruese)

për prindërit dhe fëmijët prej 2 deri 5 vjeç

Prindërit dhe fëmijët takohen rregullisht në orët e përbashkëta të historisë në gjuhën e tyre amë. Animuesja ju fton për këtë, që të tregoni tregime në mënyra të ndryshme, të luani me këngë dhe vargje poezish, të bëni ndonjë punë dore sipas një udhëzuesi për përdorim, të shikoni libra me figura për fëmijë.

Kënaqësia e përbashkët për gjuhën

Me gjuhën mund të luhet më së miri. Vjersha, këngë dhe lojëra me lëvizje bëjnë që fëmija juaj të përjetojë se sa dëfruese mund të jetë gjuha.



Arsimim të mëtejshëm për ndërmjetësuesit ndërkulturorë

Animoret janë ndërmjetësuese ndërkulturore. Ata arsimohen më tej nga SIKJM dhe shoqërohen profesionalisht.

Animimet janë falas për familjet pjesëmarrëse. Ata zhvillohen në qendrat e lagjeve dhe në biblioteka. Vizitat shtëpiake mundësojnë krijimin e kontakteve personale.

Të tregosh tregime dhe të shikosh fotografi

Tregimet dhe fotografitë i hapin fëmijës tuaj botë të reja. Ai mund ti hulumtojë ato së bashku me ju dhe të njohë shumë terma të reja.



Gjuhë të ndryshme

Animimet gjuhësore zhvillohen në gjuhët në vijim: në shqip, arabisht, në gjuhën kurde, portugalisht, në gjuhën boshnjake, kroate, serbe, në gjuhën spanjolle, tamile dhe turke.

Animimet shtesë i drejtohen një publiku multikulturor dhe i tërheqin të gjitha gjuhët e familjeve pjesëmarrëse.

Të zbuluarit së bashku të shkrimit

Shenjat e shkrimit dhe simbolet e mahnitin fëmijën tuaj. Me ndihmën tuaj ai mund tju ofrohet fshehtësirave të shkrimit. Letra dhe lapsat e ftojnë atë për eksperimentim.



Shkuarja në biblioteka

Librat mund të bëhen shokë të ngushtë.

Në biblioteka ju ju lejohet së bashku me fëmijën tuaj që të huazoni libra në shtëpi.



Të përkrahurit e shumë gjuhëve

Fëmija juaj mund të mësojë njëkohësisht mirë dy apo tre gjuhë. Këtu i ndihmojnë atij rregulla të qarta, se kur cila gjuhë duhet folur.



Krijim kontaktesh

Mos u brengosni: në kontakt me fëmijët gjermanishtfolës dhe të rriturit, fëmija juaj e mëson shpejt gjermanishten. Mundësoni ju atij kësajsoj kontakte p.sh.: në grupe loje ose në shtëpi.



Bibliotekat ndërkulturore

Bibliotekat ndërkulturore në Zvicër ofrojnë libra në shumë gjuhë të ndryshme. Ata janë të organizuara në organizatën VBOGS (Verein Bücher ohne Grenzen – Shoqata libra pa kufij). www.interbiblio.ch

Bibliomedia Zvicër

Bibliomedia Zvicër mund të huazohen libra në njëmbëdhjetë gjuhë të ndryshme nga bibliotekat e qytetit, nga bibliotekat e komunave, nga mësuesit dhe nga bibliotekat e shkollave. www.bibliomedia.ch

Instituti Zviceran për Mediat Fëminore dhe Rinore SIKJM

SIKJM-ja me mbështetjen e komisionit të mëparshëm për të huajt EKA, të qendrave integruese të kantoneve të ndryshme, si dhe të fondacionit AVINA ka zhvilluar projektin *Më dhuro një tregim - Family Literacy*. Në 2008-tën projekti u vlerësua me çmimin «Alpha» të komisionit zviceran të UNESCO-s ndaj luftës kundër dobësive të theksuara në lexim dhe shkrim të të rriturve. SIKJM-ja angazhohet tashmë për zhvillimin e mëtejshëm dhe zgjerimin specifik të projektit *Më dhuro një tregim - Family Literacy*.

Nxitja për lexim, kërkimi shkencor dhe dokumentacionet në fushën e letërsisë së fëmijëve dhe të rinjve janë detyrat kryesore të SIKJM-së, e cili ka degët edhe në Romandie dhe në Tessin. Përkrahet gjithashtu nga zyra federale e kulturës, nga sekretariati shtetëror për arsim dhe shkencë si dhe nga Kantoni dhe qyteti i Zyrihut.

Schweizerisches Institut für Kinder- und Jugendmedien SIKJM

Zeltweg 11, CH-8032 Zürich
Tel. +41 (0)43 268 39 00
info@sikjm.ch
www.sikjm.ch



SIKJM

Schweizerisches Institut für Kinder- und Jugendmedien